

**RUAJTJA DHE ZHVILLIMI I IDENTITETIT ARBËRESH NË ITALI**

**EKSPOZE E PUNIMIT MASTER**

**NGA**

**FLAKA BERISHA**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË  
STUDIME PASUNIVERSITARE – MASTER**

**SHTATOR, 2022**

# REZYME E TEMËS MASTER

## Ruajtja dhe zhvillimi i identitetit arbëresh në Itali

**Mentori: Prof. Asoc.Dr. Fadil Maloku**

**Kandidatja: Flaka Berisha**

Diaspora shqiptare paraqet njërin nga akterët kryesor në zhvillimin shoqëror, politik e madje në modernitetin e vonshëm që patën ndikim kyç në zhvillimin ekonomik. Punimi "*Ruajtja dhe zhvillimi i identitetit arbëresh në Itali*" është një studim i bazuar në analizën sociologjike për faktorët që ndikuan në ruajtjen, konsolidimin dhe në vazhdimësinë e identitetit arbëresh. Punimi është fokusuar në dimensionin kohor (historik) si dhe në studimin e detajuar të strukturës sociale bashkëkohore. Pos këtij dimensionit, është studiuar me theks të veçantë roli i këtij komuniteti në kulturën e më vonshme shqiptare përmes veprave artistike, letrare, e filozofike që dolën nga ky komunitet.

Pikërisht pjesa e parë e punimit adreson, dukurinë e migrimit në Arbëri; duke i shpalosur valët e mëdha dhe ngulitjet fillestare të këtij komuniteti. Me tu nisur nga aspekti deskriptiv historik, është theksuar se identiteti i aso kohe ishte sfidë e përgjithshme kolektive. Duke vlerësuar problemin e mos njohjes, pikërisht pikënisja e punimit vë theksin në format, funksionin dhe procesin e organizimit të kujtesës kolektive. Derisa përmes analizës së përmbajtjes është vlerësuar prodhimtaria kulturore, artistike si dhe zhvillimi i shtypit që përtej kontekstit arbëresh ato kishin rëndësi për zhvillimin e identitetit kombëtar shqiptar.

Nga dimensionin historik është theksuar po ashtu zhvillimi i mendimit politik, filozofik dhe atij social; duke pasur parasysh kontaktin e hershëm me rrymat kulturore që kishin zënë fill në Evropë. Personalitete të shumta bashkë me veprat e tyre janë bërë objekt i studimit, jo vetëm për rëndësinë apo pozicionin në aspektin kombëtar por edhe për zhvillimin e mendimit në përgjithësi. Sidomos në fushën e kulturës dhe vendosjen e bazës studimore për historinë arbërore, krijimtaria arbëreshe është fundament dhe pikë referuese. Kështu një shumësi e

materialeve si literaturë klasike arbëreshe, tekste religjioze, gazeta janë përdorur për analizë të rrymave të mendimit që kishin karakterizuar këtë komunitet.

Në pjesën e dytë të punimit, lexuesit ballafaqohet me një analizë të detajuar të elementeve të kulturës si: ritet, simbolet dhe simbolikat, arkitektura, vendbanimet, arti dhe muzika. Të gjitha këto të analizuara nga një pikëpamje që vazhdimisht për bazë ka elementet karakterizuese të modernitetit: industrializimin, urbanizimin, nacionalizmin, shtetin-komb. Në përgjithësi, brenda këtij punimi mund të gjendet një ndarje e theksuar në mes religjionit dhe sistemit kulturor, ndonëse kjo nuk qe e lehtë duke pasur parasysh kontekstin kohor që arbëreshët kishin emigruar. Sido që të jetë ka një vijë dalluese mes dy elementeve brenda punimit, duke shfaqur secili sistem në karakterin e tij dhe funksionin brenda komunitetit, tek arbëreshët ky dallim mund të vërehet. Gjithsesi duke mos minimizuar rolin e njëjës apo tjetrës si dhe duke pasur parasysh sa të lidhura e të përcaktuara në mënyrë reciproke janë dy sistemet.

Ky punim shpërfaq disa nga problemet që ky komunitet has. Këto probleme janë dëshmuar në dy forma: përmes treguesve statistikor që lidhen me migrimin ndër-regjional në Itali, dhe argumentimit sociologjik për kulturën moderne e lidhur me shoqëritë e konsumit dhe kulturës masive.

Pjesa e fundit e punimit i kushtohet gjuhës si elementi kryesor i identitetit të komunitetit si formë të ruajtjes së kujtesës në kontekstin bashkëkohor. Kjo e fundit duke marrë parasysh si fakt ekzistencën e dy shteteve me kulturën shqiptare, dhe rolin e internetit si mediumi më i fuqishëm i komunikimit në kontekstin e modernitetit të avancuar.